



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**POLITIKAT E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E MJEDISIT**

**Miratuar me Vendimin e Dekanatit
Nr. 150 datë 21.12.2021**

Dhjetor 2021



1. Hyrje

Politika e BE në lidhje me ambientin e ka zanafillën e saj që me Këshillin e Evropës mbajtur në Paris 1972, ku krerët e shteteve deklaruan nevojën e një politike komunitare në lidhje me ambientin që shoqëron zhvillimin ekonomik dhe kërkuan një plan veprimi.

Akti Unik evropian i 1987, ndërkaqi një term të ri “Ambienti”, i cili krijoi bazën e parë juridike për një politikë ambientale të përbashkët që ka si qëllim ruajtjen e cilësisë së ambientit, mbrojtjen e shëndetit njerëzor dhe garantimin e një përdorimi racional të burimeve natyrore. Traktati i Maastrichtit, 1993, e bëri ambientin një sektor zyrtar të politikës së BE. Traktati i Amsterdamit 1999, përcaktoi detyrimin e integritit të mbrojtjes së ambientit në të gjitha politikat sektoriale të BE me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm.

Traktati i Lisbonës, 2009 pati si qëllim specifik “luftën kundër ndryshimeve klimaterike” ashtu si dhe përvijimi i zhvillimit të qëndrueshëm në lidhje me vendet e treta.

Gjithashtu edhe Shqipëria me hartimin e ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ligj ky i përfruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar.¹ kërkon pikërisht t’i japë mbrojtjes së mjedisit bazën ligjore të nevojshme me qëllim ruajtjen dhe mosdëmtimin e tij.

Bazuar dhe në këtë frymë edhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, UT, ka ndërmarrë nismën që të jetë një fakultet “Green” dhe synon të bëhet promotor sensibilizimi i brezave të rinj por jo vetëm me qëllim që ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit të shndërrohen në një objektiv konceptual parësor si në aspektin individual ashtu edhe në atë komunitar e social.

¹Numri CELEX: 32004L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr 143, datë 30.4.2004, faqe 56-75.



Lidhur me këtë ai ka hartuar një sistem politikash që ky fakultet mendon të zbatojë në lidhje me ruajtjen e mjedisit duke synuar ndërgjegjësimin e studentëve dhe jo vetëm, me qëllim krijimin e ndjenjës qytetare dhe vetëdijes komunitare, cilësi këto që duhet të jenë pjesë e përbashkët e qenësisë dhe ekzistencës tonë njerëzore si përgjegjës për ruajtjen e mjedisit ku në jetojmë dhe operojmë çdo ditë.

Ndër këto politika të cilat do të jenë në fokusin e përditshëm tonin po përmendim:

1. Bashkëpunimin e ngushtë me strukturat dhe organizmat shtetërore dhe private që merren me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit:

- Njohjen edhe informimin e politikave të këtyre strukturave;
- Njohjen edhe informimin me aktivitetet që ato zhvillojnë në kuadër të këtij aspekti:
 - Pjesëmarrja në këto aktivitete
- Bashkërendimin e veprimtarive të përbashkëta:
 - Formim dhe informim në kuadrin e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit;
 - Leksione të hapura me ekspertë të kësaj fushe.
- Hartimin e përbashkët me këto struktura apo organizma të: programeve, projekteve, etj., në kuadrin e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit.

2. Hartimin e programeve lidhur me edukimin mjedisor si:

- a) Njohjen dhe nxitjen e një vetëdije personale dhe komunitare në lidhje me planetin dhe burimet e tij;
- b) Njohjen dhe krijimin e një stili jetese që respekton dhe mbrojt mjedisin;



- c) Krijimin dhe nxitjen e një raporti individual dhe komunitar gjithëpërfshirës në lidhje me ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij;
- d) Krijimin e kompetencave dhe aftësive dhe vëzhgimit kritik të mjedisit;
- e) Nxitjen dhe sensibilizimin individual dhe komunitar ndaj natyrës dhe ambientit që na rrethon e më gjerë;
- f) Njohjen me sjelljet e njeriut që nuk respektojnë dhe dëmtojnë mjedisin;
- g) Zhvillimin dhe nxitjen e sjelljeve reaguese ndaj sjelljeve dëmtuese;
- h) Marrjen e masave si kundërpërgjigje ndaj të gjithë atyre që nuk respektojnë dhe dëmtojnë mjedisin;
- i) Nxitjen e veprimtarive individuale dhe komunitare të përbashkëta për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit;
- j) Nxitjen e kontributeve vullnetare të individëve dhe komunitetit për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit;
- k) Nxitjen e nismave me plan individual dhe komunitar për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit.
- l) Nxitjen dhe pjesëmarrjen në aktivitete brenda dhe jashtë këtij fakulteti që kanë në fokus mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit

3. Zhvillimin e aktiviteteve didaktike informuese – formuese si:

- a) Shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në ndotjen e mjedisit
- b) Mbrojtja e ujërave dhe deteve
- c) Ajri dhe ndotja
- d) Ushqyerja e qëndrueshme
- e) Menaxhimi i mbetjeve: mbledhja e diferencuar dhe përpunimi
- f) Green economy: green jobs & green talent
- g) Qyteti dhe zhvillimi i qëndrueshëm: ndotja, konsumi i tokës dhe mbetjet
- h) Përshtatja ndaj ndryshimeve klimaterike



i) Mbrotja e biodiversitetit: Flora dhe Fauna

4. Zhvillimin e Olimpiadave, konkurseve me tematikë mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit
5. Ruajtja dhe mbajtja pastër e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të këtij fakulteti
6. Përdorimi me kriter i letrës:
 - përdorim i letrës kur është domosdoshmëri
 - përdorimi në format elektronik i materialeve që nuk kanë nevojë të printohen
7. Përdorimi me kriter i sistemit të ngrohjes dhe ftohjes:
 - Përdorim me orar dhe atëherë kur është e domosdoshme
8. Krijimi i hapësirave të gjelbërta:
 - mbjellje bimësh dhe pemësh
9. Krijimi i hapësirave ortokulturore:
 - kultivim perimesh etj.
10. Përdorimin e mjeteve lëvizëse që nuk ndotin ambientin:
 - biçikleta dhe monopatinë
 - nxitjen e lëvizjes në këmbë për distanca të pranueshme
11. Përdorimi me kriter i detergjenteve:
 - përdorim në sasi të kufizuar dhe detergjentë me impakt sa më të vogël mbi ambient apo detergjentëve bio.
12. Përdorimi me kriter i energjisë elektrike:
 - përdorim i kursyer i ndriçimit gjatë ditës dhe kontroll për moslënie ndezur pajisjesh kur nuk përdoren.
13. Përdorimi me kriter i pajisjeve elektronike dhe fikja e tyre kur nuk përdoren.
14. Përdorimin e materialeve të ricikluara për nevojat e fakultetit.
15. Ndalimin e përdorimit të plastikës: qese, gota, shishe, kontenitorë, ambalazhime, paketime, etj.
16. Vendosja e koshave me diferencim mbetjesh.



Politikat në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja do të jenë përparësi zbatuese e Dekanatit, personelit akademik dhe atij ndihmës akademik dhe domosdoshmërisht dhe pandashmërisht e studentëve të këtij fakulteti.

Qëllimi është një gjithëpërfshirje në këtë nismë e kujtdo që punon e studion në këtë fakultet me moton **#Nesjellimmëtëmirënsëbashku#**. Le ta sjellim atë edhe në këtë sektor kaq të rëndësishëm të jetës dhe brezave që do të vijnë pas nesh sepse **#Zëri i Tokës na thërret#**

Referenca

https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/rp_sustainable_europe_it_v2_ëeb.pdf

<https://www.europarl.europa.eu/factsheets/it/sheet/71/politica-ambientale-principi-general-i-e-quadro-di-riferimento>

https://ec.europa.eu/environment/strategy/biodiversity-strategy-2030_it

https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en

<http://www.akm.gov.al/assets/ligji-nr.-10431%2C-dat%C3%AB-9.6.2011--p%C3%ABr-mbrojtjen-e-mjedisit.pdf>

<http://www.unesco.it/it/Neës/Detail/440>

Miratoi

Dekani

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

